



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.2

Mars 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhja e datës 11.3.2004

A. VENDIME TË MIRATUARA NGA KËSHILLI I MINISTRAVE

1. Për krijimin e Komitetit shtetëror të minoriteteve.
2. Për disa ndryshime në vendimin nr 459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Komitetit shtetëror për kultet."
3. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, për dëmshpërblimin e ish-punonjëseve të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos në Fushë-Krujë.
4. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.595, datë 29.12.1993 të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e shpalljes së konkurseve, me karakter kombëtar e lokal dhe dhënien e çmimeve për to"
5. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të pronave të paluajtëshme të bashkisë së Elbasanit.
6. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të komunës Hysgjokaj.
7. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të komunës Gradishtë.
8. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të komunës Krujë.
9. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të komunës Grabian.
10. Për kontributin e qeverisë shqiptare në ngritjen e Ushtrisë Kombëtare Afgane, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.
11. Për transferimin në pronësi, bashkisë së qytetit të Rrëshenit, të degës së mobilizimit, e cila e cila është në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të

(Vijon në faqen 2)

Në këtë numër do të lexoni:

1. **Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave**
faqe 1-2
2. **Nga procesi i integritimit në Bashkimin Europian BE**
faqe 3
3. **Dispozita ligjore që lidhen me pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit legjislativ**
faqe 3
4. **Nga punimet e Kuvendit për periudhën 15-31 mars 2004**
faqe 4-6
5. **Kalendari 2 javor i Kuvendit, 29 mars-8 prill 2004**
faqe 5-6

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj,

Kuvendi i Shqipërisë me dt.30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare.

Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumenta zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë. Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.

Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 - 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP."

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

- pronave të paluajtëshme, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.
12. Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurën “Prokurimi i drejtëpërdrejtë” për riparimin e teknikës së transportit e të agregatëve.
 13. Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për riparimin e teknikës së ndërlidhjes dhe të xhenios.
 14. Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Qipros, për asistencën e ndërsjelltë administrative, për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe luftës ndaj shkeljeve doganore.
 15. Për antarësimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit në Komitetin Ndërkombëtar dhe Regjistrimin e Kafshëve (ICAR).
 16. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për krimin e Fatmir Bekajt, Fatbardha Bekajt dhe Denis Bekajt, në moshë.

B. TË NDRYSHME

Për shpallje ditë zie kombëtare ditën e enjte, datë 11.3.2004, në shenjë solidariteti me popullin dhe qeverinë spanjolle, në nderim të viktimave të akteve terroriste, të datës 11.3.2004 në Madrid, Spanjë.

II. Mbledhje e datës 18.3.2004

A. PROJEKTLIGJE

1. Vendim për miratimin e propozimit të projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.8615, datë 1.6.2000, “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Vendim për miratimin e propozimit të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Infrastruktura ujore bashkiake”.

B. VENDIME

1. Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave.

2. Për miratimin dhe kontrollin e fondit dhe veprimtaritë specifike të shërbimit Informativ Usharak.
3. Për kriteret dhe masën e kompensimit të dëmeve shkaktuar pronës së punonjësit të policisë ushtarake, gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj.
4. Për transferimin në pronësi të bashkisë së qytetit të Fushë-Krujës të degës së mobilizimit, e cila është në administrim të Ministrisë së mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.
5. Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurën “Prokurimi i drejtëpërdrejtë”, Për riparimin e teknikës së mjeteve të blinduara dhe autoagregate.
6. Për mënyrën e llogaritjes, të caktimit dhe të pagesës së përfitimeve për punonjësit që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake.
7. Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Shëndetësisë të mjedisëve të ish-repartit të policisë, prane Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
8. Për një shtesë fondi Ministrisë së rregullimit të territorit dhe të Turizmit, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ujësjellësve nga KESH-sh.a.
9. Për një ndryshim në vendimin nr.594, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së konsumatorit, të formës “ROT”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjitikës e Ministrisë së Ekonomisë dhe shoqërisë “Kurum International” sh.p.k Tiranë, për fabrikën e oksigjenit në Elbasan”.
10. Për një ndryshim në vendimin nr. 822, datë 11.12.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për shitjen me ankand të hotel “Tirana International”.
11. Për një shtesë në vendimin nr 424, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.
12. Për miratimin në parim të protokollit shtesë të marrëveshjes së garancive në të gjitha veprimtaritë bërthamore të Shqipërisë, ndërmjet

Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Ndërkombëtare të energjisë Atomike.

13. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bullgarisë , për bashkëpunim në fushat e shoqërisë së informacionit, të telekomunikacioneve dhe të shërbimeve postare.
14. Për disa ndryshime në vendimin nr.215, datë 16.5.2002 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit negociator shqiptar, për përgatitjen e negociatave me Komisionin European dhe shtetet anëtare të Bashkimit European, për nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit” të ndryshuar.
15. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.333, datë 29.5.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”.
16. Për dhënie ndihme financiare zotit Hajdar Dervishi, polic i vrarë në detyrë.
17. Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të Qarkut të Dibrës.
18. Për dhënie ndihme financiare zotit Xhemal Rakip Shemeti, polic i vrarë në detyrë.
19. Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të Qarkut të Beratit.
20. Për lejimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për shtypëshkrimin e çertifikatave të gjendjes civile me elementë sigurie.
21. Për miratimin në parim të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Japoneze për financimin e projektit “Për rritjen e prodhimit ushqimor” 2.UR në Shqipëri:

C. UDHËZIME

1. Për format dhe procedurat e identifikimit dhe të raportimit nga organet që liçensojnë personat fizikë e juridikë, në funksion të procesit të parandalimit të pastrimit të parave.
2. Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtëshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Nga procesi i integritimit në BE

1. Raundi i 4-ët zyrtar i Negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit do të zhvillohet më 22 prill 2004 në Tiranë.

Negociatat do të fokusohen në diskutimin e disa neneve që kanë të bëjnë me bashkëpunimin në fushën e lëvizjes së njerëzve (si problemi i vizave, menaxhimi i kufijve, azili, migracioni dhe parandalimi e kontrolli i emigracionit ilegal) dhe në rishikimin e disa neneve të tjera të Marrëveshjes që kanë të bëjnë me forcimin e institucioneve dhe respektimin e rregullave të së drejtës (të ligjeve), me luftën kundër terrorizmit, pastrimit të parave, bashkëpunimi për luftën kundër drogave të paligjshme, parandalimi dhe lufta kundër krimit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme.

Gjithashtu do të negociohen nenet mbi bashkëpunimin financiar të cilat parashikojnë përfitimin nga Shqipëria të asistencës financiare nga Komuniteti në formën e granteve dhe kredive në mënyrë që të arrihen objektivat e kësaj Marrëveshje.

Së fundi do të negociohen dhe "Dispozitat institucionale, të përgjithshme dhe përfundimtare" të cilat parashikojnë ngritjen e strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri për monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe përcakton disa dispozita të përgjithshme që lidhen me zbatimin e kapitujve apo neneve të veçanta të Marrëveshjes.

Disa nga strukturat e rëndësishme do të jenë Këshilli i Stabilizim Asociimit dhe Komiteti Parlamentar i Stabilizim Asociimit.

2. Në datën 23 prill 2004 do të zhvillohet takimi i tetë i Grupit Këshillimor të Përbashkët Bashkim Europian – Shqipëri (CTF-8), i cili do të ketë në axhendën e diskutimit luftën kundër krimit të organizuar dhe masat që janë marrë kundër tij nga Qeveria Shqiptare. Ky takim vjen mbas takimit Ministerial të Bashkimit Europian me Ministrat e Drejtësisë dhe të Rendit Publik të vendeve të Europës Juglindore. Kryesisht diskutimi do të fokusohet në masat legislative dhe programet konkrete që ka marrë Qeveria Shqiptare për luftën kundër krimit të organizuar, për mbrojtjen e dëshmitarëve që bashkëpunojnë me drejtësinë, për ngritjen e Gjykatës së Krimeve të Rënda, strukturat e ngritura dhe forcimi i kapaciteteve, statistikat konkrete të luftës kundër krimit të organizuar, bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Rendit, etj.

Gjithashtu, në këtë takim do të diskutohet dhe Kontrolli i Brendshëm Publik Financiar (PIFC) dhe Auditimi i Jashtëm ku përfshihen sistemet e kontrollit të brendshëm, politikat që zhvillon Qeveria në drejtim të kontrollit të brendshëm, trajnimi i kontrollorëve financiare, zbatimi i ligjit për kontrollin e brendshëm, pavarësia funksionale e kontrollit të brendshëm, sistemet e harmonizuara të Kontrollit Financiar, Auditimi i Brendshëm, dhe së fundi Kontrolli i Jashtëm që realizohet nëpërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Dispozita ligjore që lidhen me pjesëmarrjen e publikut në procesin legjislativ

Rregullorja e Kuvendit, miratuar me vendimin e Kuvendit nr.357, datë 9.4.1998, ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr.399, datë 4.2.1999

- Neni 35

Mbledhjet e Kuvendit bëhen të hapura, me përjashtim të rastit kur Kuvendi vendos ndryshe.

- Neni 36

Kuvendi mund të vendosë zhvillimin e mbledhjes me dyer të mbyllura për raste të veçanta.

Kërkesën për të zhvilluar mbledhjet e Kuvendit me dyer të mbyllura mund ta bëjë Presidenti i Republikës, Kryeministri ose 1/5 e deputetëve, duke e motivuar atë.

Pas dëgjimit të kërkesës dhe diskutimeve rreth saj, vendoset me votim të hapur, me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Kur vendoset që mbledhja të zhvillohet me dyer të mbyllura, drejtuesi i seancës u kërkon personave të ftuar, si dhe personave nga publiku dhe media që të largohen nga salla.

Nuk mund të zhvillohet mbledhje me dyer të mbyllura gjatë shqyrtimit të buxhetit ose të projektligjeve të tjera financiare.

- Neni 38

Në mbledhjet e Kuvendit mbahen procesverbale stenografike dhe bëhet regjistrimi i tyre. Çdo deputet, si dhe çdo person tjetër i interesuar ka të drejtë të njihet me këto procesverbale.

Procesverbalet, diskutimet dhe regjistrimet radiotelevizive të mbledhjeve me dyer të mbyllura administrohen sipas rregullave të ruajtjes së sekretit shtetëror. Vendimet që merren shpallen publikisht.

- Neni 48

Kalendari i punimeve të Kuvendit përcakton në mënyrë të detajuar, sipas programit, kohën se kur Kuvendi i zhvillon punimet në seancë plenare ose në komisione gjatë ditëve të caktuara të javës. Kalendari publikohet dhe u shpërndahet deputetëve, si dhe u vihet në dispozicion mediave.

- Neni 56

Mbledhjet e komisionit bëhen të hapura, me përjashtim të rasteve kur komisioni merr vendim që ato të bëhen të mbyllura.

Personat që marrin pjesë në mbledhjet e mbyllura të komisioneve janë të detyruar që të respektojnë kërkesat e ligjit për ruajtjen e sekretit shtetëror, si dhe të mos japin të dhëna për jetën private të individëve të ndryshëm.

- Neni 62

Në mbledhjet e komisioneve të përhershme mbahet procesverbal i shkurtër që firmoset nga kryetari dhe sekretari i komisionit. Këto procesverbale mund t'u vihen në dispozicion deputetëve, si dhe mediave me kërkesën e tyre.

- Neni 66

Komisioni, për çështje të caktuara, organizon seanca dëgjimi publike me përfaqësues të organizatave joqeveritare, si dhe të subjekteve të tjera të interesuara.

- Neni 127

Kopje të projektligjeve u vihen në dispozicion edhe përfaqësuesve të mediave, si dhe personave të tjerë të interesuar, me kërkesën e tyre, nëpërmjet zyrës së shtypit.

- Neni 163

Seancat e pyetjeve, interpelancave dhe mocioneve jepen të plota në RTSH. Për raste të tjera vendoset me mirëkuptim nga Byroja e Kuvendit, duke u këshilluar edhe me kryetarin e Komisionit të Përhershëm të Mjeteve të Informimit Publik.

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 15-31 MARS 2004

1. Projektligj “Për legalizimin e shtesave në ndërtim”

Ky projektligj ka për objekt rregullimin ligjor të shtesave të paligjshme të kateve dhe shtesave anësore që janë bërë gjatë zbatimit të projekteve me leje ndërtimi, legalizimin e tyre dhe, më pas, regjistrimin e tyre në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Gjatë diskutimit në parim të projektligjit deputetët u shprehën pro zgjidhjes ligjore për legalizimin e këtyre shtesave. Por, një pjesë e madhe e deputetëve pretenduan se projektligji nuk është i plotë, se masa e penaliteteve, që duhet të paguajnë firmat e ndërtimit sipas projektligjit është e vogël dhe nuk e parandalon vazhdimin e shkeljes së lejes së ndërtimit gjatë zbatimit të projekteve. Për të gjykuar lidhur me këtë problem, Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit thirri në një mbledhje të tij Kryetarin e Shoqatës së Bashkive dhe Kryetarin e Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, të cilët paraqitën opinionet e tyre për masën e penaliteteve që duhet të paguajnë subjektet juridike që kanë kryer shtesa pa leje gjatë zbatimit të projekteve të ndërtimit. Gjatë diskutimit të projektligjit Kuvendi diskutoi e votoi disa propozime të deputetëve për masën e penaliteteve që duhet të paguajnë subjektet ndërtuese, duke vendosur detyrimin që të paguajnë 20 për qind të vlerës së investimit të sipërfaqes tej lejes së miratuar për banesa dhe 50 për qind të vlerës së investimit të sipërfaqes tej lejes së miratuar për objekte të natyrave të tjera. Gjithashtu, Kuvendi miratoi edhe disa ndryshime të tjera në formulimin e disa prej neneve të projektligjit.

2. Projektligj “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Projektligji synon të rregullojë me një ligj të ri statusin e ushtarakut, duke parashikuar në të fitimin dhe humbjen e statusit të ushtarakut, kushtet e pranimit në Forcat e Armatosura, të drejtat e gradës dhe karrierës, të cilat kanë munguar në ligjin ekzistues; trajtimin me pagë të personelit ushtarak të Forcave të Armatosura me një skemë të re, ndryshe nga skema ekzistuese; caktimin e shtesave mbi pagë për kushte dhe natyrë të veçantë vendi dhe shërbimi, si dhe të kompensimeve për strehim dhe ushqim; të drejtat shoqërore të ushtarakut dhe të familjes së tij, që nënkuptojnë, veç të tjerave, edhe trajtimin me pagë të bashkëshortes ose bashkëshortit të ushtarakut, kur ai ose ajo humbet vendin e punës, trajtimin e ushtarakëve aktivë kur dalin në lirim apo pension pleqërie, si dhe disa të drejta të tjera.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët u shprehën dakord në parim me trajtimin e veçantë ekonomik e financiar të ushtarakëve, por ata u ndalën në efektin financiar që jep në shpenzimet e Buxhetit të Shtetit ky projektligj, fatura e të cilit është shumë e lartë dhe nuk mund të përballohet tërësisht nga buxheti i parashikuar për Ministrinë e Mbrojtjes. Për këtë arsye, Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit kërkoi nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave një informacion të plotë për shtesën

e shpenzimeve dhe detajimin e saj për çdo lloj përfitimi që do të kenë ushtarakët pas miratimit të projektligjit. Nga informacioni i Ministrisë së Mbrojtjes rezultoi se një pjesë e përfitimeve të parashikuara në projektligj janë përfshirë në shpenzimet e buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2004, ndërsa disa të tjera jo. Në këto kushte, me propozim të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, Kuvendi ra dakord që plotësimi i kërkesave për një trajtim të veçantë të ushtarakëve të zbatohet shkallë-shkallë brenda dy vjetëve, duke miratuar në radhë të parë ato përfitime që kanë të bëjnë me trajtimin financiar nëpërmjet ngritjes së pagave dhe duke lënë për zbatim në një kohë të mëvonshme plotësimin e disa të drejtave shoqërore të ushtarakëve dhe familjeve të tyre. Kjo do të realizohet nëpërmjet detyrimeve që i vihen në ligj Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore, afati i të cilave është i shkallëzuar sipas llojit të drejtave që parashikojnë.

3. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”

Ky projektligj synon të rregullojë disa mangësi të ligjit ekzistues e në veçanti, ato që kanë vështirësuar procesin e vendimmarrjes për vendosjen e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, si dhe për dhënien në përdorim dhe tjetërsimin e pronave të pushtetit vendor.

Gjatë diskutimit të projektligjit deputetët theksuan se procesi i decentralizimit po ecën me hapa të ndadalta dhe i kërkuan Këshillit të Ministrave shpejtimin e këtij procesi. Gjithashtu, ata kërkuan që këshillat e bashkive e komunave të përcaktojnë rregulla e procedura të qarta për zgjedhjen e kryesive të fshatrave nga populli. Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin duke ndryshuar formulimin e disa neneve të tij.

4. Raport mbi veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2003

Në Raport analizohet veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2003, jepen në mënyrë të detajuar të dhëna për zbatimin e buxhetit të këtij institucioni, hartimin dhe zbatimin e planit strategjik dhe metodikave të kontrollit, pasqyrohen përpjekjet për kualifikimin e stafit kontrollues dhe për informatizimin e këtij institucioni, si dhe përshkruhet veprimtaria ndërkombëtare e tij. Pjesën kryesore të Raportit e ze veprimtaria kontrolluese. Më pas, në Raport pasqyrohen në mënyrë analitike të dhëna për shkeljet ligjore të kryera nga administrata publike, të cilat janë konstatuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke theksuar faktin që vlera e dëmit ekonomik në krahasim me një vit më parë është ulur. Gjithashtu, në Raport kritikohet veprimtaria procedurale e Prokurorisë për hetimin e denoncimeve të paraqitura nga ky institucion.

Gjatë debatit të zhvilluar në seancë plenare lidhur me këtë Raport deputetët, si të pozitës, ashtu edhe të opozitës,

(Vijon në faqen 6)

KALENDAR I

2 JAVOR (29 MARS - 8 PRILL 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

E Hënë, datë 29.03.2004, ora 17.00

-Seancë Plenare

1. Miratimi i Programit të Punës të Kuvendit për periudhën 29 Mars - 30 Qershor 2004.
 2. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.
 3. Interpelancë me Ministrin e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, kërkuar nga deputeti Maksim Begeja.
 4. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.
 5. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Financave.
 6. Raport i Këshillit Drejtues të Radio Televizionit.
- Pyetje dhe diskutime.

E Martë, datë 30.03.2004

E Mërkurë, datë 31.03.2004

- Punë në komisione për

shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji "Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës".
-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit (e ka shqyrtuar)
-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës (e ka shqyrtuar)
2. P/Ligji "Për industrinë joushqimore".
-Komsioni i Ligjeve
-Komisioni i Industrisë
-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës
3. P/Ligji "Për shërbimin publik funeral".
-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)
-Komisioni i Industrisë

4. P/Ligji "Për kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për organizimin e ndarjes Administrativo-Territoriale të Republikës së Shqipërisë".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

5. P/Ligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

6. P/Ligji "Për miratimin e Kodit Detar Shqiptar".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Mbrojtjes

-Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacionit

7. P/Ligji "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

8. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 "Për Festat Zyrtare e Ditëve Përkujtimore", i ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve

9. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Mjeteve të Informimit Publik

10. P/ligji "Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr. 7748 date 29.07.1993 "Per statusin e ish te denuarve dhe te Perndjekurve Politike nga sistemi komunist", ndryshuar ne ligjin nr. 7771 date 07.12.1993".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomise dhe Financave

-Komisioni i te Drejtave te Njeriut

-Komisioni i Punes dhe Çeshtjeve Sociale.

11. Dekret nr. 4181 date 23.03.2004 "Kthimi per shqyrtim edhe nje here ne Kuvend te ligjit nr. 9198 date 26.02.2004 "Per nje shoqeri gjinore te barabarte".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Punes dhe Çeshtjeve Sociale

-Komisioni i te Drejtave te Njeriut

konvente të vitit 1978, të ndryshuar".

2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së ekstradimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit".

3. P/Ligji "Për medaljet për personelin e forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë".

PER VOTIM:

P/rezoluta per Çeshtjen e Popullsisë Çame.

Raport i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Pyetje dhe diskutime.

(Vijon në faqen 6)

(Vijon nga faqja 5)

**E Hënë, datë 5.04.2004, ora
17.00**

-Seancë Plenare

1. Përgjigje e pyetjeve të deputetëve Valentin Palaj, Muhamet Ukperaj, Ligoraq Karamelo dhe Nikollë Lesi nga Ministri i Transporteve dhe Telekomunikacionit.
2. Raport i Governorit të Bankës së Shqipërisë.
- Pyetje dhe diskutime.

E Martë, datë 6.04.2004

E Mërkurë, datë 7.04.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:
1. P/Ligji "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Punës dhe

Çështjeve Sociale

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

-Komisioni i Industrisë

2. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8366, datë 2.7.1998 "Për shërbimin gjeologjik shqiptar (Sh.Gj. Sh.).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Industrisë dhe

Telekomunikacionit

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

3. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë".
4. P/Ligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9118, datë 24.7.2003 "Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të paguara".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Industrisë dhe

Telekomunikacionit

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Punës dhe

Çështjeve Sociale

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8950, datë 10.10.2002 "Për Gjendjen Civile".

-Komisioni i Ligjeve

6. P/Vendim "Për shfuqizimin e tarifave të telefonisë fikse dhe të çmimeve të energjisë elektrike".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Industrisë dhe

Telekomunikacionit

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

**E Enjte, datë 8.04.2004, ora
10.00**

-Seancë Plenare

1. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8576, datë 3.02.2000 "Për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë".
2. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre".
3. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë".
4. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8677, datë 2.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".

Departamenti i

Procedurave Parlamentare

Nga punimet e Kuvendit

(Vijon nga faqja 4)

e vlerësuan pozitivisht atë. Përfaqësuesit e Qeverisë shprehën gadishmërinë e tyre për rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të këtij institucioni. Disa deputetë, veçanërisht ata opozitarë, theksuan se shkeljet ligjore të përmendura në Raport flasin për punë të pamjaftueshme nga administrata shtetërore për zbatimin e ligjeve. Megjithë vlerësimin që i bënë përpjekjeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në luftë kundër zbulimit të shkeljeve ligjore dhe korrupsionit, disa deputetë kërkuan përmirësimin e cilësisë së punës dhe rritjen e profesionalizmit të këtij institucioni. Nga disa diskutantë u theksua se duhet thelluar shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke zbatuar të gjitha masat administrative të paraqitura në to. Lidhur me mënyrën e llogaritjes së dëmit ekonomik, disa diskutantë theksuan se duhen përmirësuar metodikat e llogaritjes së tij, duke përfshiruar nga vlera totale e dëmit ekonomik disa mosrealizime plani.

Gjithashtu, gjatë diskutimit disa deputetë bënë vërejtje për mënyrën e hartimit të Raportit, i cili, sipas tyre, duhet të pasqyrojë vetëm veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe jo shkeljet ligjore të kryera në institucionet e tjera buxhetore, pasi ato janë objekt i Raportit për zbatimin e Buxhetit të Shtetit. Nga deputetët u shprehën mendime për përmirësimin e mënyrës së raportimit të institucioneve të pavarura, duke e përshtatur atë me praktikat institucionale në vende të tjera. Sipas tyre, është e nevojshme të bëhen rregullime procedurale, duke parashikuar raportimin e përfaqësuesve të institucioneve të pavarura në komisionet përkatëse të përhershme të Kuvendit, ndërsa në seancë plenare të paraqitet një raport i shkurtuar i institucioneve të pavarura dhe të dëgjohet mendimi i komisioneve përkatëse.

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasherit, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org